

Të nderuar kolegë,

Si përfaqësues i Vlorës, kam detyrën e vështirë t'i përgjigjem një nevoje të dyfishtë: Si fillim, kërkesës së qytetarëve për t'u dëgjuar, më pas domosdoshmërisë politike që ky regjim i kalbur na shtrëngon t'i drejtohem jo si veprimtari e zakonshme parlamentare. Thirrja që banorët e çdo zone më drejtuan gjatë takimeve të zhvilluara me ta, ishte: mos na harroni! E kisha në mendje këtë, duke parë show-n e radhës, takimin e Kryeministrit me kryebashkiakët. Sinqerisht, më vjen mirë që më në fund Kryeministrit tonë i ka rënë në sy që Shqipëria ka probleme me plehrat, edhe pse duket sikur vjen nga një dimension tjetër. Por edhe në këtë qasje nuk mungon arroganca e tij, duke vendosur prioritetin për vegimin e vet të radhës, kur thotë se duhet të shpenzohet pothuajse edhe 100% e buxhetit të bashkive për këtë punë. Jam dakord të mos mbytemi nga plehrat, të mos e kemi këtë njollë në sytë e vizitorëve dhe të miqve që na vijnë, por a mendon ky Kryeministër se njerëzit kanë nevoja më jetike sesa plehrat, në këtë buxhet? Mendoj se jo, sepse ai është arrogant edhe me vuajtjet dhe urinë kur deklaron se nuk ka vdekur për bukë asnjë shqiptar, që nga koha e Skënderbeut. Kjo bën të marrë vlerë shprehja: "Nuk pyet i ngopuri për të uriturin". Zotëri, nëse nuk i ke parë njerëzit që vuajnë, do të thotë se në rastin më të mirë nuk njeh realitetin, por të garantoj se administratorët e tu lokalë i dinë mirë, sepse shfrytëzojnë mizorinë e tyre për të blerë votën, që të mbajnë ty në pushtet. Nëse do të bësh të paditurin, mund të të tregoj se mjafton të lëvizësh në periferitë e Vlorës apo pak kilometër, dhe i ke atje. Nuk dua të bëj retorikë që këtë buxhet e do për të gjithë miqtë e koncesioneve të plehrave. A ka një njeri që nuk e kupton fasadën e radhës së Kryeministrit tonë, që për të larguar vëmendjen nga problemet më madhore që ka ky vend, po kujdeset si zakonisht për buzëkuqin e Shqipërisë, kur stomaku e ka bosh! Përgjegjësia për gjithçka që është bërë apo nuk është bërë në këtë vend në këto tetë vjet, është vetëm e tij, ekskluzivisht e tij. Si mund të kujtoresh tani për ato që s'ke bërë apo për shpërdorimet në këto tetë vjet të 800 milionë eurove për ujën, ndërkohë që njerëzit nuk kanë ujë të pijshëm, ndonëse e paguajnë atë? Do t'ju lutesha të shikonit vetëm një sekuencë. (Debat në sallë) Në Cerkovinë, Skroftinë, Trevllazër, Babicë, Alikokë, Kaninë, Bestrovë, Kërkovë, Hoshtim, Zvërnec, Panaja, Nartë, Mekat, Bunavi, Risili nuk ka ujë të pijshëm, ose maksimumi ka një orë në ditë, ndonëse e paguajnë atë. Në Aliban, në Akërminë, Novoselë, në Fitore, në Bishan, në Mifol, në Poro, në Delisuf, në Dëllënjë, në Llakatund, sistemi i kullimit dhe i vaditjes, siç e përmenden edhe kolegët e tjerë, është i amortizuar prej dekadash dhe nuk mbaron ngërçi me certifikimin e pronave. Në Risili, Çeprat, Sherrisht, Grabian, jetojnë si në getot e Bangladeshit. Trishtimi dhe zemërimi për gjendjen të të cilën ndodhen, lexohet në sytë e tyre, me shpresën dhe besimin e humbur tek e ardhmja. Kanë tridhjetë vjet që paguajnë taksat e shtetit, por shërbime nuk kanë. Gjatë këtyre tetë vjetëve, janë bërë zero investime nga qeveria. Fermerët vuajnë mungesën e subvencioneve; prodhimet vuajnë mungesën e tregut; banorët vuajnë mungesën e shërbimit urban, që i lidh me Vlorën. Vlora vetë, njëlloj si periferia, ku vetëm furrat e bukës, kafenetë dhe mikromarketet po shtohen, ndahet e ndahet si bakllava, diku sipas një koncepti kaotik e të shthurur, diku sipas sistemit zhatës, plotësisht të strukturuar. Të ashtuquajturat projekte zhvillimi sot në Vlorë janë një ujdi tipike për këtë regjim, propagandë ngjyrash e formash pa identitet e pa asnjë miratim popullor, në shërbim të leverdisë ekonomike të sekserëve të hambarit. Rasti më tipik i kësaj formule zhatjeje, është historia e

zhvendosjes së portit të mallrave nga skela në Triport. Vlora nuk ka treg, se u mbyll me fasadën. Vlora po shkërmoqet në çdo lagje, mjaft që të dalësh 15 metra nga rruga qendrore e qytetit, le pastaj të shkosh në Çole, Kume, Karabash e në lagjen Kushtrimi. Vlora ka mbetur pa banja publike, qëkur filloi rikonstrukcioni i “Sheshit të Flamurit”. Vlonjatët e dinë mirë se për çfarë bëhet fjalë. Vlora po humbet edhe universitetin. Vlora po kthehet përditë në një azil të madh e në një çerdhe depresioni për të gjithë. Do të tregoj vetëm një sekuencë të shkurtër, një histori me një mikun tim të ardhur nga jashtë, të cilin e çuam në Vlorë në një hotel në Lungomare. E çuam gjatë natës dhe të nesërmen në mëngjes, duke lëvizur për marrëdhënie pune në një vend tjetër, në një cep tjetër të Vlorës, më pyeti me ironi: “Prapë në të njëjtin qytet ku ishim dje, jemi?” Sepse e kishim çuar gjatë natës. Vinte nga aeroporti dhe ishte i lodhur. “Jemi në të njëjtin qytet ku ishim dje?”, -tha duke parë Lungomaren, sepse e zgjuam kur ishte në skelë. Natyrisht, Kryeministri tallet. Për të mbajtur pushtetin i mjafton ushtria elektorale prej 12 mijë të punësuarish disa muaj para zgjedhjeve, shto edhe familjarët e tyre. Kjo është magjia e tij politike për t’iu shmangur llogaridhënies që lëmoshën e kthen në pushtet, ndërsa hajdutërinë në progres. Tani më duhet t’i kthehem edhe një herë saktësimit për çmimin e naftës që është përmendur përsëri nga i nderuari zoti Kryeministër. Është e vërtetë që në 2013-ën nafta ka qenë 190 lekë për litër, por ai lë pa thënë se në bursë atë vit çmimi ka qenë 110 dollarë për ton, ndërsa sot është 83. Pra, ka një diferencë prej 32 përqindësh. Me kutin e Kryeministrit, nëse bursa do të mbante të njëjtën prirje, si në 2013-ën, shto taksat e kësaj qeverie, që përbëjnë 65 % të çmimit për çdo litër karburant, ka të ngjarë të shkojmë drejt çmimit 230 lekë për litër. Uroj që kjo të mos ndodhë për shqiptarët, sepse tendenca është e tillë. Ju faleminderit të gjithëve!